

RENDI I DITËS

“Për rihapjen e shortit për caktimin e ekspertëve kontabël të licensuar për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga 8 parti politike për vitin kalendarik 2020”.


PJESËMARRJA :

Stafi KQZ: Y.Merkaj, V.Ballgjini, E.Podgorica

Z.Y.Merkaj: Atëherë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në datën 12.07.2021 është hedhur shorti për përzgjedhjen e ekspertëve kontabël, të licensuar për auditimin e fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2020 dhe për auditimin e fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore të datës 25 prill 2021. Duke qenë se në datën 22.07.2021, njëri nga ekspertët kontabël, zonja Fatime Alliu është tërhequr nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2020. Vazhdojmë me procedurën e hedhjes së shortit për auditimin e fondeve të shpenzuara dhe të përfituara për vitin kalendarik 2020. Për këtë procedura është e njëjtë si shorti i parë. Në një enë transparente do të vendosen emrat e 13 ekspertëve kontabël, të cilët nga shorti i datës 12 korrik, u ka rënë për të audituar 7 parti politike. Ndërsa në enën tjetër transparente do të vendosim partitë politike, Partia Demokracia Sociale, Partia Republikane, Partia e Prosperitetit Demokratik të Shqipërisë, Partia Ardhmëria Shqiptare, Partia Emigracioni Shqiptar, Partia Demokracia e Re e Djathtë Shqiptare, Partia Aleanca Kombëtare dhe Partia Sfidë për Shqipërinë.

Zbardhi materialin audio

Merita Dulaku



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Shortit për ekspertët kontabël
Dt.23.07.2021*

Vazhdojmë me palosjen e shiritave të letrave ku janë shënuar emrat e ekspertëve kontabël:

Aida Maloku,

Margarita Kalemasi,

Neshat Maze,

Erilon Saraçi,

Anila Pulaj,

Eleonora Telo,

Ludmilla Paluka,

Silvana Gjikhima,

Eneida Rrahmani,

Hidajete Kraja,

Anida Nuri,

Fatmira Sykja Kastrati.

Enkeleda Alite,

Ndërsa në enën tjetër transparente do të vendosim partitë politike. Fillojmë me leximin dhe palosjen e shiritave të letrave ku është shënuar emri i partisë politike që do të auditohet:

Partia Demokracia e Re e Djathtë Shqiptare,

Partia Demokracia Sociale,

Partia Republikane Shqiptare,

Partia e Prosperitetit Demokratik të Shqipërisë,

Partia Ardhmëria Shqiptare,

Partia Emigracioni Shqiptar,

Partia Aleanca Kombëtare dhe Partia Sfida për Shqipërinë.

Vazhdojmë me përzierjen e goglave në enën e parë, ku janë ekspertët.


Nga përzierja doli:

Ekspertja Eneida Rrahmani, e cila do të auditojë fondet e përfituara dhe të shpenzuara për vitin kalendarik 2020 të partisë politike, Partia Demokracia e Re e Djathtë Shqiptare;

Ekspertja Ludmilla Paluka, do të auditojë fondet e përfituara dhe të shpenzuara për vitin kalendarik të partisë politike, Partia Emigracioni Shqiptar;

Zbardhi materialin audio

Merita Dulaku



Procesverbali i zbardhur i seancës publike të

Shortit për ekspertët kontabël

Dt.23.07.2021

Ekspertja Hidajete Kraja, do të auditojë fondet e përfituara dhe të shpenzuara për vitin kalendarik 2020 të partisë politike, Partia Republikane e Shqipërisë;

Ekspertja Silvana Gjikhima, do të auditojë fondet e përfituara dhe të shpenzuara për vitin kalendarik 2020, të partisë politike, Partia e Prosperitetit Demokratik të Shqipërisë;

Ekspertja Margarita Kalemasi, do të auditojë fondet e përfituara dhe të shpenzuara për vitin kalendarik 2020 të partisë politike, Partia Demokracia Sociale;

Ekspertja Anida Nuri, do të auditojë fondet e përfituara dhe të shpenzuara për vitin kalendarik 2020 të partisë politike, Partia Sfida për Shqipërinë;

Ekspertja Aida Maloku, do të auditojë fondet e përfituara dhe të shpenzuara për vitin kalendarik 2020 të partisë politike, Partia Aleanca Kombëtare;

Ekspertja Fatmira Sykja Kastrati, do të auditojë fondet e përfituara dhe të shpenzuara për vitin kalendarik 2020 të partisë politike, Partia Ardhmëria Shqiptare.

Ky ishte dhe rezultati i shortit të datës 23 korrik 2021. Faleminderit!

Vendimi nr.431

Zbardhi materialin audio

Merita Dulaku

**23.07.2021
Ora 12:27**

RENDI I DITËS

“Për rihapjen e shortit për caktimin e ekspertëve kontabël të licensuar për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga 2 subjekte zgjedhore për fushatën zgjedhore, të datës 25 prill 2021”.

PJESËMARRJA :

Stafi KQZ: Y.Merkaj, V.Ballgjini, E.Podgorica


Z.Y.Merkaj: Atëherë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në datën 12.07.2021 është hedhur shorti për përzgjedhjen e ekspertëve kontabël, të licensuar për auditimin e fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2020 dhe për auditimin e fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore të datës 25 prill 2021. Duke qenë se në datën 22.07.2021, njëri nga ekspertët kontabël, zonja Fatime Alliu është tërhequr nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2020, si dhe nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore të datës 25 prill 2021 do të hidhet shorti për subjektet zgjedhore dhe partitë politike, të cilat janë përzgjedhur. Duke qenë se nga shorti i datës 12.07.2021, ekspertja Fatime Alliu ka pasur të paaudituar dy subjekte zgjedhore, subjektin zgjedhor Boiken Abazi dhe subjektin zgjedhor Partia Bashkimi Liberal Shqiptar.

Do të hidhet shorti sipas procedurës së mëposhtme:

Në dy shirita letre të bardhë do të shënohen emrat e subjekteve zgjedhore, të cilat do të futen në dy gogla me formë, ngjyrë dhe peshë të njëjtë, do të hidhen në një

Zbardhi materialin audio

Merita Dulaku



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Shortit për ekspertët kontabël
Dt.23.07.2021*

enë transparente, ndërsa në 6 shirita letre të tjerë, do të vendosim emrat e ekspertëve kontabël, të cilëve nga shorti i datës 12.07.2021 u ka rënë të auditonin nga një subjekt zgjedhor. Emrat e mëposhtëm, janë ekspertët:

Vullnetare Hoxha,

Margarita Kalemasi,

Lejla Dobi,

Hidajete Kraja,

Anita Pulaj,

Eftali Qiriaqi.

Emrat e tyre janë shënuar në shiritat e letrave, do të palosen dhe do të futen në goglat me formë, ngjyrë dhe peshë të njëjtë dhe do të përzihen. Goglat janë në dy enë transparente. Do të tërhiqet në goglën e parë emri i ekspertit dhe do të tërhiqet në goglën e dytë emri i partisë politike. Emri i ekspertit, i cili do të tërhiqet i pari do të auditojë subjektin zgjedhor që do të dalë nga ena e dytë. Po, vazhdojmë! Palosen shiritat e letrës, Vullnetare Hoxha, Eftali Qiriaqi, Lejla Dobi, Margarita Kalemasi, Hidajete Kraja, Anita Pulaj.

Boiken Abazi, subjekti zgjedhor Boiken Abazi, do të futet në enën e dytë transparente dhe subjekti zgjedhor Partia Bashkimi Liberal Shqiptar, pasi paloset letra, futet në goglën me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë, hidhen në enën e dytë transparente dhe një përfaqësuese e KQZ-së do të përziejë goglat e enës së parë, ku janë emrat e ekspertëve.

Margarita Kalemasi është ekspertja që do të auditojë fondet e përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore, të subjektit zgjedhor Partia Bashkimi Liberal Shqiptar.

Vazhdojmë me përzierjen e goglave.

Hidajete Kraja është ekspertja që do të auditojë fondet e përfituara/shpenzuara të subjektit zgjedhor për fushatën zgjedhore, të subjektit zgjedhor Boiken Abazi.

Ky ishte dhe rezultati i shortit të datës 23 korrik 2021. Faleminderit!

Vendimi nr. 432

Zbardhi materialin audio

Merita Dulaku

